



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 2 gusht 2024  
Nr. Ref.: RK 2487/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI71/24**

Parashtrues

**Fehmi Kupina**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [ARJ. nr. 217/2023] të 21 dhjetorit  
2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Fehmi Kupina, me vendbanim në fshatin Bardhosh, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Shkelqim Jakupi, avokat në Komunën e Fushë Kosovës.

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [ARJ.nr. 217/2023] të 21 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktvendimin [AA. nr. 769/2023] e 27 tetorit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), dhe Aktvendimin [A. nr. 1461/2023] e 18 gushtit 2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [ARJ.nr.217/2023] të 21 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 mars 2024, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 mars 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI71/24] caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi, gjyqtar raportues ndërsa përmes Vendimit [nr. KSH. KI71/24] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 15 prill 2024, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhje e fakteve

### **(i) Procedura për shkarkimin e parashtruesit të kërkesës nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit komunal**

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte zgjedhur Kryetar i Kuvendit të Komunës së Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi Komunal), më 5 janar 2023.

10. Më 27 qershor 2023, gjatë një mbledhjeje të Kuvendit Komunal, të udhëhequr nga anëtari më i vjetër i saj, përmes Vendimit [01-060/01-135488/23], parashtruesit i kërkesës u shkarkua nga detyra e Kryetarit të Kuvendit Komunal (në tekstin e mëtejme: Vendimi për shkarkim).
11. Më 7 korrik 2023, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (në tekstin e mëtejme: MAPL), pasi kishte pranuar për shqyrtim të ligjshmërisë aktet e Kuvendit Komunal, të miratuara në seancën e 27 qershorit 2023, përmes shkresës drejtuar Kryetarit të Prishtinës dhe parashtruesit të kërkesës kishte theksuar se vendimet e Kuvendit Komunal të mbajtur më 27 qershor 2023, nuk “krijojnë asnjë efekt juridik”.
12. Nga shkresat e lëndës rezulton se përkitazi me procedurën që kishte rezultuar në Vendimin për shkarkimin e parashtruesit të kërkesës, MAPL-ja kishte hapur konflikt administrativ përmes padisë së paraqitur në Gjykatën Themelore.
13. Më 31 gusht 2023, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [A. nr. 1429/2023], kishte aprovuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës që atij t'i njihet statusi i palës së interesuar.
14. Gjykata nuk ka informacion përkitazi me statusin e këtyre procedurave gjyqësore apo nëse të njëjtat kanë përfunduar dhe se ato nuk janë objekt i shqyrtimit të kësaj kërkesë.

**(ii) Procedura përkitazi me zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunal pas shkarkimit të parashtruesit të kërkesës nga kjo pozitë**

15. Më 19 korrik 2023, ishte ftuar mbledhja e Kuvendit Komunal për zgjedhjen e kryesuesit të ri të Kuvendit Komunal.
16. Më 20 korrik 2023, MAPL-ja i rekomandoi Kuvendit Komunal që mbledhja për zgjedhjen e kryesuesit të mos mbahet pa zhvilluar procedurat për shkarkimin e parashtruesit të kërkesës.
17. Më 21 korrik 2023, Kuvendi Komunal, përmes Vendimit [01-020/01-151871/23], zgjodhi P.B kryesues të ri të Kuvendit Komunal.
18. Më 26 korrik 2023, kundër Vendimit të Kuvendit të 21 korrikut 2023 për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, parashtruesi kërkesës parashtrroi ankesë në MAPL, si dhe kishte njoftuar Komunën e Prishtinës se duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në tekstin e mëtejme: LPPA), ndaj Vendimit të lartcekur kishte paraqitur ankesë në MAPL, prandaj, sipas tij, Vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk mund të prodhojë efekte juridike deri në zgjedhjen e ankesës.
19. Më 1 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës ndaj Komunës së Prishtinës inicioi konflikt administrativ përmes padisë për anulimin e Vendimit [01-020/01-151871/23] të Kuvendit Komunal në Gjykatë Themelore, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të lartcekur. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se vazhdimi i mbledhjes së anëtarëve të Kuvendit të 27 qershorit 2023 është anuluar si dhe vendimet e asaj mbledhjeje nuk kanë prodhuar efekt juridik, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që ta kthejë në pozitën dhe funksionin e kryesuesit të Kuvendit, si dhe t'ia shpërblejë dëmin material.
20. Më 3 gusht 2023, MAPL-ja i kishte adresuar Komunës së Prishtinës kërkesën që bazuar nënën 82 (Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (në tekstin e mëtejme: LVL)

brenda tridhjetë (30) ditësh të bëjë rishqyrtimin e Vendimit [01-020/01-151871/23] për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

21. Më 18 gusht 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 1461/2023] hodhi poshtë padinë dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit me arsyetimin se (i) Vendimi i kontestuar i Kuvendit Komunal për zgjedhjen e P.B si Kryesues ishte kontestuar përmes konfliktit administrativ pa kaluar afati tridhjetë (30) ditor për rishqyrtim të vendimit sipas kërkesës së MAPL-së, ashtu siç përcaktohej në nenit 82 të LVL-së, prandaj akti administrativ nuk është përfundimtar; dhe se (ii) parashtruesit të kërkesës i mungon interesi juridik përkitazi me Vendimin e kontestuar.
22. Më 29 gusht 2023, parashtruesi i kërkesës ndaj Aktvendimit [A. nr. 1461/2023] të Gjykatës Themelore, ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar se në rastin konkret kishte vendim përfundimtar administrativ dhe se ai kishte interes juridik në rastin në fjalë, pasi vendimi për shkarkimin e tij nga pozita e Kryesuesit të Kuvendit komunal ishte i paligjshëm.
23. Më 27 tetor 2023, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AA. nr. 769/2023], refuzoi si të pabazuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, duke mbështetur arsyetimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit, po ashtu theksoi se parashtruesi i kërkesës nuk atakon në këtë procedurë vendimin për shkarkimin e tij por vendimin për emërimin e Kryesuesit të ri të Kuvendit Komunal.
24. Më 22 nëntor 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të Gjykatës së Apelit, në Gjykatën Supreme duke pretenduar se ai kishte interes juridik në rastin në fjalë dhe se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit duke mos trajtuar në merita rastin e tij, kanë cenuar edhe të drejtën për mjete juridike.
25. Më 23 dhjetor 2023, përmes Aktvendimit [ARJ. nr. 217/2023], Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se Vendimi [01-020/01-151871/23], i 21 korrikut 2023 i Kuvendit komunal, nuk është një vendim përfundimtar dhe se parashtruesit të kërkesës i mungon interesi juridik.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [ARJ. nr. 217/2023] i Gjykatës Supreme cenon të drejtat dhe liritë themelore të tij të përcaktuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
27. Parashtruesi i kërkesës, pretendimet i tij për shkelje kushtetuese, i ndërlihdh me interpretimin e gabuar të dispozitave ligjore, e që si pasojë e kësaj kanë ardhur në konkluzionin se ai nuk ka interes juridik në këtë çështje, respektivisht, (i) shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, dhe (ii) pamundësisë që t'i shfrytëzonte në kuptim efektiv mjetet juridike bazuar në të drejtat e garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës.

*Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës*

28. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për shkak të mungesës së një vendimi përfundimtar të procedurës administrative të atakuar, por Gjykata Supreme ka interpretuar gabimisht

dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejshëm: LKA), në rastin konkret, pasi që nuk ka marrë në konsideratë pjesën e paragrafit 2 të nenit 15 të LKA-së, në të cilin theksohet se “*mund të zhvillohet konflikti administrativ kur organi me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ i ka kapërcyer kufijtë e kompetencës*”. Megjithatë, sipas parashtruesit të kërkesës, nga materialet dhe vëzhgimet e MAPL-së është e qartë se ky është një rast i “*mosmarrëveshjes*” mes palëve, ku thelbi është tejkalimi i kompetencave të Kuvendit Komunal, veçanërisht në lidhje me faktin nëse Kuvendi Komunal ka krijuar një situatë kundërligjore me dy kryetarë të Kuvendit Komunal dhe se kjo është në kundërshtim me dispozitat e nenit 41 (Kryesuesi i kuvendit të komunës) të LVL-së.

29. Më tej, parashtruesi i kërkesës argumenton se Gjykata Supreme nuk ka interpretuar si duhet paragrafin 4 të nenit 82 të LVL-së. Ai vlerëson se ky paragraf aplikohet vetëm në raportin e mbikëqyrjes ndërmjet MAPL-së dhe komunës, dhe jo në procedurat administrative të individëve ose organizatave administrative, që i janë nënshtruar LPPA-së. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës vë në dukje se dispozita parashikon tri situata kur një akt i Kuvendit konsiderohet si akt përfundimtar dhe kur fillon procedura gjyqësore, konkretisht, nëse komuna nuk përgjigjet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, kur komuna refuzon kërkesën për rishqyrtim, ose kur komuna mbështet aktin e kontestuar. Ai argumenton se Komuna e Prishtinës ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim dhe ka mbështetur aktin e kontestuar, duke filluar ekzekutimin e tij, pavarësisht kërkesës së MAPL-së. Pra, afati prej tridhjetë (30) ditëve i përmendur, sipas parashtruesit të kërkesës, aplikohet vetëm për kohën brenda të cilës Kuvendi Komunal mund ta rishqyrtojë aktin, dhe nuk përfshin afatin pas të cilit vendimi merr karakter përfundimtar, duke theksuar se të gjitha mosveprimet apo veprimet e mëtejshme dëshmojnë qartë se komuna refuzon, mbështet dhe zbaton aktin e kontestuar.
30. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës argumenton se Gjykata Supreme nuk ka mbështetur vendimin e saj në nenin 85 (Ankesat e qytetarëve) të LVL-së, që parashikon që ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve komunale shqyrtohen sipas LPPA-së. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës argumenton se Gjykata Supreme nuk ka marrë parasysh as nenin 124 (Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative) të LPPA-së. Parashtruesi i kërkesës thekson se procedurat e kundërshtuara të vendimeve të Kuvendit ndryshojnë nga procedurat e shqyrtimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës, megjithatë, pretendimet e tij lidhur me kundërshtimin e aktit në fjalë lidhen plotësisht me dispozitat e lartpërmendura, për të cilat ligji njeh të drejtën e kundërshtimit në përputhje me ligjin e procedurës së përgjithshme administrative. Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se pavarësisht kësaj, ai konsideron se aktet e Kuvendit komunal, të publikuara në faqen zyrtare, që kanë filluar edhe ekzekutimin janë akte përfundimtare në procedurë administrative, dhe se nuk ka organ ose nivel tjetër që do t'i ndryshonte apo do të vendoste ndryshe në procedurat administrative. Këtë aspekt, sipas parashtruesit të kërkesës e përcakton edhe neni 79 (Llojet e shqyrtimit) i LVL-së, ku bën dallimin ndërmjet procedurave të shqyrtimit administrativ: shqyrtimi i ligjshmërisë dhe shqyrtimi i përshtatshmërisë dhe se në këtë rast, thekson se po trajtohet shqyrtimi i ligjshmërisë.
31. Parashtruesi i kërkesës argumenton se Gjykata Supreme nuk ka marrë në konsideratë interesin e tij juridik të drejtpërdrejtë, përfshirë zëvendësimin e tij të paligjshëm dhe humbjen e të ardhurave personale si kryesues. Ai thotë se Gjykata Supreme duhet të kishte marrë parasysh këtë dhe të kërkonte specifikime në lidhje me kërkesën e tij, në vend që ta refuzonte si të papranueshme. Më tej, parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktvendimit të saj, ka shkelur Kushtetutën duke mohuar të drejtat e mbrojtjes së barabartë para gjykatave, ministrive dhe Komunës së Prishtinës. Kjo për shkak se askush në çdo fazë të procedurave administrative dhe

gjyqësore nuk ka trajtuar në mënyrë substanciale pretendimet e tij, duke shkelur kështu nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

*Pretendimet përkitazi me shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës*

32. Lidhur me nenet 32 dhe 54, parashtruesi i kërkesës argumenton se, sipas Kushtetutës dhe legjislacionit, ka të drejtë të kundërshtojë aktin administrativ dhe ekzekutimin e tij, dhe se bazuar në legjislacion në fuqi, vendimet e kuvendeve komunale, lidhur me kompetencat ekskluzive nga neni 40 (Funksionimi i kuvendit të komunës) i LVL-së, janë vendime përfundimtare në procedurë administrative, në momentin që publikohen dhe ekzekutohen. Megjithatë, sipas tij, asnjë institucion administrativ ose gjykatë nuk ka shqyrtuar ose vendosur mbi kërkesat për mosekzekutim të aktit të kundërshtuar.
33. Tutje, sipas parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme i ka “*mohuar të drejtën e parashtrimit, përkatësisht trajtimin meritore të mjetit juridik*”, në të dy procedurat, atë administrative dhe gjyqësore përfshirë kërkesat e lidhura me shtyrjen e zbatimit të vendimit të kontestuar, e që rrjedhimisht është përballur me shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës.
34. Prandaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, dhe si pasojë (iii) të konstatojë se vendimet e kuvendeve komunale, lidhur me kompetencat ekskluzive nga neni 40 i LVL-së, janë vendime përfundimtare në procedurë administrative, në momentin që publikohen dhe ekzekutohen, (iv) të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [ARJ. nr. 217/2023] e 21 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme; dhe (v) të kthejë Aktvendimin [ARJ. nr. 217/2023] e 21 dhjetorit 2023 të Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

## **Dispozitat relevante kushtetuese**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 31**

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

[...]

#### **Neni 32**

#### **[E Drejta për Mjete Juridike]**

*“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.”*

#### **Neni 54**

#### **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”*

## **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

### **Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)**

- 1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.  
[...]*

## **Ligji nr. 03/l-202 për Konfliktet Administrative**

### **Neni 10**

- 1. “Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejt apo interes ligjor.”*

### **Neni 15**

- 1. “Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet:  
1.1. kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ;  
1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;  
1.3. kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.*
- 2. Në çështjet nga nën-paragrafi 1.2. i paragrafit 1. të këtij neni mund të zhvillohet konflikti administrativ kur organi me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ i ka kapërcyer kufijtë e kompetencës.”*

### **Neni 34**

- 1. “Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se:  
1.1. padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohëshme;  
1.2. akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ;  
1.3. është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj;*

- 1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;
  - 1.5. është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ;
  - 1.6. ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje.
2. Për shkaqe të parashikuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës.”

## **Ligji nr. 05/l -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative**

### **Neni 124**

#### **Legjitimimi, Shkaqet dhe Mjetet Juridike Administrative**

1. “Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtari i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë.
2. Përveç nëse caktohet ndryshe me ligj, mjetet juridike administrative mund të ushtrohen për shkak të paligjshmërisë.
3. Mjetet juridike administrative, të rregullta, janë:
  - 3.1. ankesa;
  - 3.2. kundërshtimi administrativ;
4. Mjet juridik administrativ përjashtimor është rihapja e procedurës administrative.
5. Pala mund t'i ushtrojë vetëm një herë mjetet juridike administrative të rregullta për të njëjtën çështje.
6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste:
  - 6.1. nuk ekziston organi epror;
  - 6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo
  - 6.3 parashikohet shprehimisht me ligj.”

## **Ligji nr. 03/l-040 për Vetëqeverisjen Lokale**

### **Neni 41**

#### **Kryesuesi i kuvendit të komunës**

“41.1 Kuvendi i komunës e zgjedh kryesuesin e kuvendit të komunës nga radhët e anëtarëve.



41.2 Kryesuesi i kuvendit të komunës zgjedhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit;

41.3 Votimi në të gjitha zgjedhjet për kryesues të kuvendit të komunës është me vota të fshehta.

41.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

41.5 Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjedhet kryesues i kuvendit të komunës.”

## **Neni 82 Procedura për shqyrtimin e ligjshmërisë**

“82.1 Nëse autoriteti mbikëqyrës konsideron se një vendim apo një akt i komunës nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjet, ai mund të kërkojë që komuna ta rishqyrtojë vendimin apo aktin e tillë. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkëlqes së kushtetutës apo ligjit dhe nuk suspendon ekzekutimin e vendimit komunal apo akteve të tjera.

82.2 Organi i njësisë së vetëqeverisjes lokale i përgjigjet kërkesës për rishqyrtim, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës.

82.3 Nëse komuna pranon kërkesën për rishqyrtim, ajo mund të suspendojë ekzekutimin e vendimit të kontestuar apo aktit deri në shqyrtimin e saj nga autoritetet lokale.

82.4 Nëse komuna nuk përgjigjet brenda afatit apo refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund ta kundërshtojë aktin në fjalë në Gjykatën e Qarkut që është kompetent për territorin e komunës, brenda 30 ditësh pas dështimit për t'iu përgjigjur njoftimit për refuzimin apo mbështetjen e vendimit apo aktit të kontestuar.”

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

35. Gjykata, së pari, shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

#### Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

*[...].”*

37. Gjykata i referohet edhe nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë), që përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Rregulli 34  
(Kriteret e Pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë te pranueshme nëse:*

*(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar,*

*[...].”*

38. Duke iu referuar dispozitave të mësipërme, Gjykata duhet fillimisht të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesën e tij në përputhje me dispozitat e përmendura të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës.
39. Në rastin konkret, Gjykata fillimisht rikujton se në mbledhjen e Kuvendit Komunal, të mbajtur më 27 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës ishte shkarkuar nga pozita e kryesuesit të Kuvendit Komunal. Në vijim të kësaj, MAPL-ja inicioi procedurën gjyqësore përmes të cilës kërkoi anulimin e vendimit në fjalë me pretendimin se mbledhja e Kuvendit komunal ishte e jashtëligjshme. Në këtë procedurë gjyqësore, e që ndërlihet me shkarkimin e parashtruesit të kërkesës nga pozita e tij si kryesues i Kuvendit Komunal, këtij të fundit Gjykata Themelore ia kishte njohur statusin e palës së interesuar. Gjykata nuk ka informata nëse procedurat gjyqësore lidhur me shkarkimin e parashtruesit të kërkesës janë në zhvillim e sipër apo të njëjtat kanë përfunduar. Pavarësisht nga kjo, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në Gjykatë këtë procedurë gjyqësore nuk e ka kontestuar dhe për pasojë nuk është edhe objekt i shqyrtimit të kësaj kërkesë.
40. Thënë këtë, rrethanat e objektit të çështjes para Gjykatës ndërlidhen me atë se më 21 korrik 2023, Kuvendi Komunal kishte zgjedhur një kryesues të ri. Si rezultat i këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës kishte iniciuar procedurën për kontestimin e këtij vendimi në MAPL dhe në vijim kishte parashtruar padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore duke kontestuar ligjshmërinë e zgjedhjes së P.B në cilësi të kryesuesit të ri të Kuvendit Komunal. Gjykata Themelore hodhi poshtë padinë dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit me arsyetimin se vendimi i kontestuar nuk është vendim përfundimtar administrativ dhe se parashtruesit të kërkesës i mungon interesi juridik. Vendimin e Gjykatës Themelore e konfirmoi edhe Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës, konteston

- Aktvendimin e Gjykatës Supreme duke pretenduar se e njëjta ka cenuar të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe të drejtën e tij për mjete juridike të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, pasi që sipas tij, gjykatat e rregullta gabimisht kanë interpretuar dispozitat e LPK-së, LPPA-së dhe LVL-së. Më specifikisht, sipas parashtruesit të kërkesës padia e tij është dashur që të trajtohet në merita sepse, ndër të tjera, ai ka interes juridik për shkak se vendimi për shkarkimin e tij është i paligjshëm dhe për pasojë edhe zgjedhja e Kryesuesit të ri të Kuvendit Komunal është po ashtu e jashtëligjshme.
41. Fillimisht, Gjykata thekson se për qëllime të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, me pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese nga autoritetet publike, para Gjykatës, mund të paraqiten (i) personat fizikë; (ii) personat juridikë; dhe (iii) grupe individësh fizikë dhe/ose juridikë, me kushtin që të kenë statusin përkatës të viktimës.
  42. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata fillimisht duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka *“statusin e viktimës”* së shkeljeve të drejtave dhe lirive të tij, të garantuara me Kushtetutë në mënyrë që të parashtrrojë kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës.
  43. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), e cila praktikë ndërlidhet me nocionin e viktimës së shkeljeve të të drejtave dhe lirive themelore, të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, respektivisht (shih në këtë rast [KI32/21](#), parashtrues *Hasan Shala*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 30 qershorit 2021). Gjykata, bazuar edhe në praktikën gjyqësore e GJEDNJ-së, ka mbajtur qëndrimin se Kushtetuta nuk parasheh konceptin e *actio popularis*, që do t'i mundësonte çdo individ të kontestojë para Gjykatës dispozitat e caktuara ligjore apo aktet e autoriteteve publike me pretendimin e mbrojtjes së interesit publik dhe/ose rendit kushtetues (shih, ndër tjerash, rastin e Gjykatës [KI30/19](#), me parashtrues *Isni Kryeziu*, Aktvendim për Papranueshmëri i 3 prillit 2019, paragrafët 28-30 dhe [KI 102/11](#), me parashtruese *Shahe Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 12 dhjetorit 2012, paragrafi 18; shih po ashtu rastin e GJEDNJ-se, *Centre for Legal Resources on Behalf of Valentin Câmpeanu kundër Rumanisë*, [nr. 47848/08](#), Aktgjykimi i 17 korrikut 2014, paragrafi 101).
  44. Thënë këtë, Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore ka theksuar se kërkesat duhet të parashtrohen nga individë apo persona juridik të cilët pretendojnë që janë viktimë e shkeljes së një ose më shumë të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Të njëjtit, bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 47 të Ligjit, duhet të dëshmojnë dhe argumentojnë që janë *“prekur drejtpërdrejt”* nga masat e autoriteteve publike ndaj të cilave ankohen (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI29/09](#), [KI32/09](#) dhe [KI47/09](#), me parashtrues *Teki Bokshi*, *Avdi Rizvanolli* dhe *Qaush Smajlaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 17 dhjetorit 2010, paragrafi 22; [KI32/21](#), me parashtrues *Hasan Shala*, Aktvendim për Papranueshmëri i 30 qershorit 2021, paragrafët 43-47; [KI175/19](#), me parashtrues *Ismajl Zogaj*, Aktgjykim i 1 korrikut 2021, paragrafi 60; dhe [KI118/10](#), me parashtrues *Shoqata e Sigurimeve të Kosovës*, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 majit 2011, paragrafët 14-19).
  45. Gjykata në këtë rast i referohet rastit të saj [KI32/21](#), rrethanat e të cilit ndërlidheshin me atë se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe njëkohësisht në cilësinë e autoritetit kompetent sipas dispozitave të Ligjit për Përgjegjësitë Disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK) sipas detyrës zyrtare kishte parashtruar kërkesë për fillimin e hetimeve ndaj një gjyqtari

në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se ky i fundit kishte kryer shkelje disiplinore, si rezultat i trajtimit jo të barabartë të palëve, pa pasur ndonjë kërkesë specifike të palëve tjera për një procedurë të tillë. KGJK kishte konstatuar se gjyqtari, subjekt i kësaj procedurë disiplinore, nuk ishte përgjegjës për shkeljet disiplinore të specifikuar në Ligjin për Përgjegjësitë Disiplinore. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës kundër vendimit të KGJK-së kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme, dhe kjo e fundit ankesën e tij e hodhi poshtë si të palejuar me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk ishte palë e autorizuar për të parashtruar ankesë në këtë gjykatë. Gjykata gjatë vlerësimit të saj, nëse parashtruesi i kërkesës ishte palë e autorizuar, përkatësisht nëse i njëjti kishte cilësinë e viktimës vlerësoi se në këtë procedurë nuk është vendosur në lidhje me të drejtat dhe liritë individuale të parashtruesit të kërkesës të garantuara me Kushtetutë. Si rrjedhojë, Gjykata bazuar në elaborimin si më sipër arriti në përfundim se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte cilësinë e viktimës, të cilit shkelja do t'i shkaktonte dëm ose do të kishte një interes legjitim dhe personal që kjo shkelje të përfundonte.

46. Po ashtu edhe GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore në parim ka theksuar se në kuptim të nenit 34 të KEDNJ-së, një individ, organizatë joqeveritare apo grup i individëve para GJEDNJ-së duhet të paraqesin se janë viktimë e shkeljes së dispozitave të KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së [Panagiotis Kalfagiannis dhe Pospert kundër Greqisë](#), kërkesa nr. 74435/14, Vendim, i 9 qershorit 2020, paragrafi 39).
47. Në vijim, Gjykata po ashtu vë në dukje konstatimin e GJEDNJ-së e cila ka theksuar se: (i) “nacioni “viktimë” është interpretuar në mënyrë autonome dhe pavarësisht nga rregullat vendore siç janë ato të pasurit interes apo mundësinë për të ndërmarrë veprime edhe pse [GjEDNJ] duhet të ketë parasysh edhe faktin që parashtruesi ka qenë palë në procedurë në gjykatat vendore” (shih rastet e GJEDNJ-së [Aksu kundër Turqisë](#), nr. 4149/04 dhe nr. 41029/04, Aktgjykim, i 15 marsit 2012, paragrafi 52; [Micallef kundër Maltës](#) nr. 17056/06, Aktgjykim, i 15 tetorit 2009, paragrafi 48; [Bursa Barosu Başkanlığı dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr.25680/05, Aktgjykim, i 19 qershorit 2018, paragrafët 109-117, dhe [Panagiotis Kalfagiannis dhe Pospert kundër Greqisë](#), i cituar më lart, paragrafi 39) dhe (ii) “individ i në fjalë duhet që të dëshmojë që është prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga masa, të cilën e konteston” (shih referencat në rastin [Qendra për Burime Juridike në emër të Valentin Câmpenau kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 47848/08, Aktgjykim i 17 korriku 2014, paragrafi 96).
48. Gjykata, duke iu rikthyer rrethanave juridike në rastin konkret, vë në dukje se parashtruesi i kërkesës në padinë e tij para Gjykatës Themelore kishte kontestuar Vendimin [01-020/01-151871/23] të Kuvendit komunal në Gjykatë Themelore, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të lartcekur me të cilin Kuvendi Komunal kishte zgjedhur P.B si Kryesues të këtij të fundit.
49. Në kërkesën e tij të parashtruar në Gjykatë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, i ka shkelur garancitë procedurale të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i mos trajtimit të padisë së tij në merita sa i përket ligjshmërisë së zgjedhjes së P.B, si Kryesues i ri i Kuvendit Komunal.
50. Gjykata, në vlerësimin, nëse parashtruesi i kërkesës ka statusin e viktimës për të parashtruar kërkesë individuale në bazë të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, rithekson se nëse një individ apo person juridik është palë në procedurë para gjykatave të rregullta, nuk nënkupton se i njëjti gëzon statusin e “viktimës” para Gjykatës me automatizëm, nëse të drejtat individuale të tij nuk preken drejtpërdrejt me aktin përkitazi me të cilin ankohet. Rrjedhimisht, pjesëmarrja apo jo e parashtruesit të kërkesës në procedurat para gjykatave të rregullta nuk është vendimtare për të

përcaktuar statusin e “viktimës” pasi ky nocion është autonom dhe interpretohet bazuar në kuptimin e palës së autorizuar të përcaktuar me Kushtetutë, Ligj dhe Rregulloren e punës (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI32/21](#), me parashtrues *Hasan Shala*, cituar më lart, paragrafët 33-43).

51. Në vijim të të lartcekurave, Gjykata sërish i referohet rastit të GJEDNJ-së *Panagiotis Kalfagiannis dhe Pospert kundër Greqisë*, ku kjo e fundit kishte theksuar se për të përmbushur kriteret e nenit 34 të KEDNJ-së, parashtruesit duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë se ata vetë drejtpërsëdrejti janë prekur nga shkelja e pretenduar e KEDNJ-së (shih rastin e GJEDNJ-së, [Panagiotis Kalfagiannis dhe Pospert kundër Greqisë](#), paragrafi 50).
52. Në vijim, të kësaj, Gjykata duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret vë në dukje se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e palës paditëse në procedurën për kontestimin e zgjedhjes së P.B si kryesues i Kuvendit Komunal ishte palë në procedura para gjykatave të rregullta, megjithatë në padinë dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të Vendimit të Kuvendit Komunal duke theksuar si të drejtat e tij ishin cenuar pasi ligjërisht ai ishte kryesues i Kuvendit Komunal.
53. Megjithatë, Gjykata vëren se procedurat për shkarkimin e tij bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal të 27 qershorit 2023, ende janë në shqyrtim para gjykatave të rregullta dhe se parashtruesi i kërkesës nuk i ka kontestuar ato para Gjykatës përmes kërkesës së tanishme.
54. Gjykata, po ashtu vë në dukje arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, e cila kishte theksuar: “Vendimi i të paditurës i datës 27.06.2023 me të cilin këtu paditësi shkarkohet nga pozita e kryesuesit të kuvendit të Kryeqytetit, e i cili vendim sjell pasojë për këtu paditësin por se i njëjti nuk atakon këtë vendim dhe nuk kërkon anulimin e vendimit në fjalë, por se referon kërkesa për kthim në pozitë dhe kompensim, kurse atakoi vendimin e datës 21.07.2023, e i cili vendim përcakton të drejta dhe detyra për palë tjetër i cili nuk është palë në këtë procedurë, në këtë mënyrë gjykata konstaton se në raport me vendimin e atakuar po ashtu mungon interesi për anulimin e të njëjtit sepse nuk dëshkohet dëmi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, për faktin se me vendimin me të cilin paditësi shkarkohet nga pozita është i datës 27.06.2023 nr.01-060/01- 135488/23 datë 30.06.2023”.
55. Bazuar në elaborimin si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës nuk ka statusin e viktimës para Gjykatës, për arsye se i njëjti nuk është i afektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Vendimi i Kuvendit Komunal i 21 korrikut 2023, për zgjedhjen e P.B-së në këtë pozitë.
56. Sipas shkresave të lëndës, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës përmes rastit të iniciuar në gjykatat e rregullta e që është objekt shqyrtimi para Gjykatës përmes kërkesës së tanishme, nuk kishte iniciuar procedurat ndaj Vendimit për shkarkimin e tij të 27 qershorit 2023, vendim ky në të cilin kishte interes juridik dhe që ishte objekt i shqyrtimit të një procedure tjetër gjyqësore, por ndaj Vendimit për Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit [01-020/01-151871/23], të 21 korrikut 2023, edhe pse ai thekson se në petitumin e propozuar ishte përfshirë edhe vendimi për shkarkimin e tij.
57. Në dritën e të lartcekurave, Gjykata, po ashtu, vë në pah se parashtruesi i kërkesës si para gjykatave të rregullta ashtu edhe para Gjykatës nuk ka dëshmuar se Vendimi [01-020/01-151871/23] për Zgjedhjen e P.B kryesues i Kuvendit, i 21 korrikut 2023, ka afektuar apo shkelur të drejtat e tij.

58. Bazuar në elaborimin si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113, nenit 47 të Ligjit dhe pikës (a) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës nuk ka statusin e viktimës para Gjykatës, për arsye se i njëjti nuk është i afektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Vendimi kontestuar i Kuvendit komunal.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës dhe me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (1) (a) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 17 korrik 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

**Gjyqtari raportues**

  
Jeton Bytyqi

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Çaka-Nimani